

“Territori i Republikës së Iliridës, përfshinë territorin historik të shqiptarëve, nga qyteti i Manastirit në jug deri në Kumanovë. Kryeqyteti i Republikës së Iliridës ka qenë dhe është Shkupi”.

Kështu Nevzat Halili me shokë, në sheshin Skënderbeu në Shkup shpalli Republikën e Iliridës.

Ata kërkojnë formimin e organeve qendrore dhe nacionale, por me përfaqësim absolutisht të barabartë, të të dy republikave dhe etniteteve brenda kufijve ekzistues.

Nevzat Halili u kërkoi Institucioneve të Maqedonisë të miratojnë vendimin, për të cilin thotë se është vullnet i popullit. Ai kërkoi gjithashtu nga kryeparlamentari Trajko Veljanovski dhe kryeministri Gruevski të shpallin referendum për të pyetur qytetarët nëse duan të jetojnë në konfederatën e re. Halili madje edhe u kërcënua.

‘Nëse këto kërkesa tona paqësore, nuk pranohen, injorohen apo dikush e dëmton ndonjë aktivist të Institucioneve të Republikës Iliridës, ta dinë se ne të gjithë do të përgjigjemi si popull, si një, duarthatë, por të drejtën e vetëvendosjes e kemi mbajt dhe e mbajmë si e kanë mbajtur dhe e mbajnë të gjithë popujt e botës’, tha Nevzat Halili, “Kryetari i Iliridës”.

Në sheshin Skënderbeu nuk mungoi muzika dhe flamujt kombëtar shqiptar.

Në aktin shpalljes së republikës së Iliridës, përkundër ftesës, munguan liderët e partive politike shqiptare dhe ambasadorët e SHBA-së dhe OSBE-së./alsat-m/

[youtube height="400" width="100%" align="none"]<http://www.youtube.com/watch?v=Pncb-2Mkzds>[/youtube]